

Data 16.08.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rehabilitimin e ambienteve egzistuese për Instalimin e aparatit të ri të Ortovoltazhit në Njësinë e Radioterapisë në Spitalin Onkologjik në QSUT”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 3,435,364.13 (tre milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër pike trembëdhjetë) leke pa TVSH dhe 3,906,237.33 (tre milion e nentëqind e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë pikë tridhjetë e tre) lekë me TVSH.

Në bazë të pikës 2 të Nenit 21 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, MSHMS në cilesinë e Autoritetit Kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1*
- b. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 të DST).

- c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
- d. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/b dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa e mesipërme i shërben Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës*”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022 dhe për gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e

taksave vendore” i ndryshuar; ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet jane kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9 dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si deshmi te përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me faturat tatimore të shitjes, ku te shënohen datat, shumat, natyra e punes se kryer së bashku me situacionet perfundimtare për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma "b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i Bashkimit te Operatoreve.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: "Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht." AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" ku qartazi përcaktohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”* .

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”*, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **NP- 1 A** Punime germimi në tokë
- **NP- 2 A** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP- 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **N.S-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- **N.S- 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat

e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategorite e licenses “N.P dhe N.S” te percaktuara ne piken 2 te kriterave te vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik jane hartuar ne përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave te secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Liçenca NP- 1 A Punime germimi ne toke, eshte vendosur fereruar punimeve qe do te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit:

A1		PUNIME DHEU		
1	2.29/a+2.37/5a	Germim dheu me mak.+transport deri 5km	m3	38,3
2	2,5	Germim dheu me krahe	m3	3
3	2.19+2.36	Mbushje, ngjeshje dheu	m3	13

Liçenca NP- 2A Ndertime civile dhe industrial, eshte kerkuar referuar punimeve qe jane parashikuar te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit si me poshte:

A2		PUNIME PRISHJE		
1	An	Heqje materiale elektrike, hidraulike, mekanike, transport materialesh ne objekt	total	
2	An	Heqje e materialeve ekzistuese dhe vendosja e tyre ne adresen qe do te caktoj QSUT	total	1
3	An	Heqje e dyerve druri ekzistuese	m ²	6
4	An	Heqje e dritareve ekzistuese	m ²	4
5	An	Prishje shtrese me pllaka dyshemeje dhe plintuesa	m ²	70
6	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	5,6
7	An	Prishje e suvatimeve te demtuara ekzistuese ne mure	m ²	50
8	An	Heqje e mermeri te dritareve	m ²	1
9	2.37/5b	Transport per heqjen e mbeturinave deri ne 7-10 km	m ³	7

Licenca NP- 3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, eshte kerkuar referuar punimeve qe jane parashikuar te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit si me poshte:

A4	PUNIME SHTRESASH			
1	2,264	Shtrese lluster çimento 1:2 nen pllaka	m ²	
4	2.262/4b	Pllake themeli, trare e bazamente b/a t=40cm C 25/30	m ³	
2	2,266	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0,78
3	2,310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m ²	50
4	2,328	Patinim muri allçi	m ²	81,7
7	An	F.V. Profile mbrojtëse për këndet e mureve të brendshëm, inoksi, plastike, metalike per ambiente spitalore	ml	5

Licenca N.S – 4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese, eshte kerkuar referuar punimeve qe jane parashikuar te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit si me poshte:

A4	PUNIME SHTRESASH			
2	2.267/b	F.V Shtirim me pllake gres porcelan importi 40 x 40 ngjitur me kolle	m ²	41
3	2.324/b	F.V Plintuse grez importi, h = 10 cm	ml	43
5	An	Trajtimi I siperfaqes me kuarc dhe helikopter	m ²	28
6	2.273/5	F.V Davancale t=3cm mermeri (dritare)	m ²	2
		Tavane me kartonxhes		
6	2.297/b	F.V Tavan i varur me fibra minerale (60 x 60 cm) ne dhoma dhe koridore	m ³	5,85
4	2,328	Patinim muri allçi	m ²	81,7
5	2.297/a	Tavane me kartonxhes	m ²	10
6	2.297/b	F.V Tavan i varur me fibra minerale (60 x 60 cm) ne dhoma dhe koridore	m ²	
A6	PUNIME DYER DHE DRITARE			
1	2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.	m ²	

				5,85
2	An	Vendosje e xhamit me plumb e veshur me kornize duralumini 40x28x2.5cm	cope	1
3	2.375/1	F.V Dritare duralumini me dopjo xham	m ²	4
4	an	Dere metalike me veshje plumbi me pllaka hekuri 2x10mm dhe pllake plumbi spesor 2.5mm	m ²	1,00
A7	PUNIME BOJATISJE			
1	2,404	Lyerje me boje hidroplastike importi	m ²	214

Licenca N.S – 12 A Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit, eshte kerkuar referuar punimeve qe jane parashikuar te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit si me poshte:

M1		INSTALIME MEKANIKE		
1	4,34	F.v. Kanale Ajri - Lllamarine Xingato 40x20cm, I vendosur ne tavan	ton	0,7
3	An.	F.v. Grile me konstrukcion alumini 300x300 mm per furnizimin dhe ekstraktimin e ajrit pershkruar si ne projekt dhe specifikime bashke me sistemin e montimit	cope	4
4	An.	F.v. Grile kundra shiut me konstrukcion alumini 40x20 cm pershkruar si ne projekt dhe specifikime bashke me sistemin e montimit	cope	2
5	An.	Tub me diameter 50 per rrjedhjen e ujit te kondicionerit, I cili lidhet me sistemin ekzistues te kullimit te ujit	m	2
6	An.	Tub celiku 100x100x5mm ne forme katrore, me gjatesi 5300mm	cope	5,3
1	An.	Njesi e jashtme kondicioneri, tipi per banesa, me rryme 18 btu	cope	1
2	An.	Njesi e brendshme kondicioneri, tipi per banesa, multispliter, me rryme 18 btu	cope	2
3	An.	Kontrollues temperature	cope	1
4	An.	Njesi kondicionimi multispliter	cope	2
5	An.	Amortizues zjarri	cope	1
6	An.	Aspirator (Q=1000 m3/h)	cope	2
1	An.	Njesi e jashtme kondicioneri, tipi per banesa, me rryme 18 btu	cope	1
2	An.	Njesi e brendshme kondicioneri, tipi per banesa, multispliter, me rryme 18 btu	cope	2
3	An.	Kontrollues temperature	cope	1

4	An.	Njesi kondicionimi multispliter	cope	2
5	An.	Amortizues zjarri	cope	1
6	An.	Aspirator (Q=1000 m3/h)	cope	2

Licenca N.S – 14 A Impiante te brendshme elektrike, `telefonike, radiotelefoni TV , eshte kerkuar referuar punimeve qe jane parashikuar te kryhen ne objekt sipas zerave te preventivit si me poshte:

PUNIME ELEKTRIKE				
E1		CELESA, PRIZA		
1	An	Kuti per celesa e priza 3-module per instalim brenda murit	cope	6
2	An	Suport 3M plastike	cope	6
3	An	Pllake 3M plastike	cope	6
4	An	Kuti per celesa e priza 4-module per instalim brenda murit	cope	1
5	An	Suport 4M plastike	cope	1
6	An	Pllake 4M plastike	cope	1
7	An	Kuti per celesa e priza 6-module per instalim brenda murit	cope	3
8	An	Suport 6M plastike	cope	3
9	An	Pllake 6M plastike	cope	3
10	An	Tapa per mbushje	cope	10
11	An	Celes I thjeshte 230V, 10A,	cope	3
12	An	Emergency stop button	cope	1
13	An	Prize shuko universale 230V, 16A	cope	16
E2		PERCJELLESA DHE KABLLO		
1	An	Kabllo Cu fuqie FROR 3x1.5mm2	ml	100
2	An	Kabllo Cu fuqie FROR 3x2.5mm2	ml	65
3	An	Kabllo Cu fuqie FROR 3x4mm2	ml	20
E3		TUBO, KUTI SHPERNDARESE, KANALINA		
1	480/2	Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe pa emetim gazi, Ø20mm me aksesore per montim	ml	70
2	An	Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe pa emetim gazi, Ø25mm me aksesore per montim	ml	65
3	An	Kanaline Zn 150x75x3000 birezuar (e kompletuar me aksesoret per montim)	ml	10
4	An	Strukture mbajtese me 2 prizhionere dhe profil C per kanalinen	cope	9
5	An	Bashkues 90 zbritje 150x75	cope	2
6	An	Bashkues T ne plan 150x75	cope	1
F1		FURNIZIM PAJISJE ELEKTRIKE		

1	An	Kuader qendror (KQ1), komplet, me gjithë elementet perberes sipas skemes principale ne vizatim, raportit teknik dhe specifikimeve teknike, I gatshem per shfrytezim.	cope	1
2	An	Ndricues LED 60x60, 4000K, antibakterial me bateri te inkorporuar	cope	8
3	An	Ndricues Tabele EXIT	cope	1
V1		VENDOSJE PAJISJE ELEKTRIKE		
1	An	Kuader qendror (KQ1), komplet, me gjithë elementet perberes sipas skemes principale ne vizatim, raportit teknik dhe specifikimeve teknike, I gatshem per shfrytezim.	cope	1
2	An	Ndricues LED 60x60, 4000K, antibakterial me bateri te inkorporuar	cope	8
3	An	Ndricues Tabele EXIT	cope	1
E4		RRJETI LAN		
1	An	Kuti per celesa e priza 3-module per instalim brenda murit / gipsit	copë	2
2	An	Suport 3M + vide	copë	2
3	An	Pllake 3M plastike	copë	2
4	An	Tapa per mbushje	copë	2
5	An	Prize RJ45 CAT.6 FTP (me skermo)	copë	4
6	An	Llambe sinjalizimi	copë	1
7	An	Modul komunikimi 1 In, 1 Out me nderfaqe rrjeti, me komunikim me paisjen	copë	1
8	An	Kabell Data FTP CAT.6A	ml	65
9	480/2	Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe pa emetim gazi, Ø20mm me aksesore per montim	ml	50

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomike:

Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, sipas standardeve:

- Certifikate **ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”**, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate **ISO 45001-2018 “Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune”**, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës b, janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike te pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

c) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar të paktën **8 (tete) punonjes te deklaruar**, minimumi per muajin qershor 2023.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet te dorezoje dokumentacionin:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku te specifikohet numri i punonjësve, për periudhën e mesiperme.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore, për periudhën e mesiperme.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 8 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Jane shumezuar sasite me kohen (te marra ne analizat e VKM-se Nr.629, date 15/7/2015) qe duhet per te perfunduar çdo ze referuar njesive (cope/m2/m3 etj). Te gjitha oret e punes qe duhet per te perfunduar çdo ze i percaktuar ne preventiv jane mbledhur dhe shumatorja e tyre eshte pjestuar me oret qe do te duhet te perfundoje objekti i proçedurës ne varesi te diteve qe jane percaktuar ne grafik (zbrit ditet e pushimit). Nga kjo llogaritje del dhe numri i punetoreve qe do te duhet per te perfunduar objektin e proçedurës.

Σ totale e oreve te punes = 1562 ore pune

Afati per te perfunduar objektin e percaktuar ne DST eshte 45 dite. Keto dite referuar Kodit te Punes (Kohezgjatja maksimale javore e punes) Neni 83 citohet:

Kohezgjatja normale e javes se punes eshte jo me shume se 40 ore. Ajo percaktohet me vendim te Keshillit te Ministrave, ne kontraten kolektive ose ne kontraten individuale te punes.

Per sa me siper kthejme kohen e percaktuar ne DST ne ore pune, zbrit ditet e pushimit (39 dite pune x 8 ore/dite) = 312 ore pune. Ne total referuar zerave te preventivit nevojiten 1562 ore pune qe te perfundoje objekti.

Pjestojme oret e punes totale te preventivit me kohen e percaktuar ne DST.

Nr.i punonjesve=1562 ÷ 312= 5.01 puntore

d) Operatori Ekonomik duhet te kete të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt inxhinieret si me poshte, ku te pakten njeri prej tyre te jete **Drejtues Teknik**.

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Inxhinieret e mesiperm duhet të figurojnë minimalisht ne listëpagesen e muajit te fundit, te kene kontrate pune te vlefshme, të deklarojne se nuk jane te angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jenë te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas Shtojcës Nr.8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate
- Diplomë profesionale
- CV

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas gërmasë d), të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Numri i stafit teknik dhe numri i inxhinierëve ndërtimi, inxhinier elektrik dhe inxhinier mekanik është përcaktuar nga pikepamja e natyrës teknike të kontratës me qëllim për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Inxhinieret nevojiten për të gjitha punimet e siperpermendura, për të miratuar materialet dhe cilësinë e tyre. Ata do të ndjekin dhe miratojnë cilësinë e punimeve të parashikuara për rikonstrukcionin e këtij objekti. Prania e tyre është e nevojshme për realizimin optimal të punimeve, instalimeve të pajisjeve dhe aparaturave, në mënyrë që objekti të funksionojë me kapacitet të plotë dhe të jetë brenda parametërve të kërkuar për të ushtruar funksionin e tij.

Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi rezulton në mungesë të plotësisht të afateve për kryerjen e punimeve, të cilësia se dobet në punime dhe jashtë normave.

Dh) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar, punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë minimumi muajsh e fundit, me profesione si më poshtë:

- 1 (nje) muratore ose specialist ndertimi
- 1 (nje) elektriciste
- 1 (nje) karpentier (per armature)
- 1 (nje) bojaxhi
- 1 (nje) mekanik ose specialist per kondiconimin

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr.8. Ndersa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin si me poshte:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, ose Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Specialistët e kërkuar sipas fushave, janë vendosur në baze të punimeve dhe llojit të tyre.

Murator/ specialist ndertimi -eshte kerkuar per realizimin e punimeve si: shtrese lluster çimento, suvatime, shtrim me pllake gres porcelan importi (40x40) ngjitur me kolle, fv plintuse grez importi, trajtim i siperfaqes me kuarç dhe helicopter, etj.

Mekanik/ specialist per kondicionimin- eshte kerkuar per realizimin e punimeve si: njesi e jashtme kondicioner, tipi per banesa, me rryme 18btu, njesi e brendshme kondicioneri, tipi per banesa, multispliter, me rryme 18 btu, kontrollues temperature, njesi kondicionimi multispliter, amortizues zjarri, etj.

Elektracist -eshte kerkuar per realizimin e punimeve kuader qendror (KQ1), komplet, me gjithë elementet perberes sipas skemes principale ne vizatim, raporti teknik dhe specifikimeve teknike, i gatshem per shrfytezim, ndricues LED 60x60, 4000K, antibacterial me bateri te inkorporuar, ndricues tabele EXIT, etj.

Karpentier -eshte kerkuar per realizimin e punimeve: pllake themeli, trare bazamente b/a t= 40cm c 25/ 30, f.v veshje me beton arme me t= 10 cm C 25/30 me aditiv per ritjen e peshes, f.v hekur betoni periodic Ø 6-10 mm, etj.

Bojaxhi- eshte kerkuar per realizimin e punimeve si: patinim muri allçi, f.v profile mbrojtese per per kendet e mureve te brendshem, lyerje me boje hidroplastike importi, etj.

2.3.3. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr .	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamionçin me kapacitet mbajtes 1.5 (nje pike pese) ton deri ne 5 (pese) ton	1 (nje) cope	Në pronësi ose me qera
2	Betoniere te vogla	1 (nje) cope	Në pronësi ose me qera
3	Depozite uji 500 l	1 (nje) cope	Në pronësi ose me qera
4	Matrapik	1 (nje) cope	Në pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) **Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) si dhe certifikaten e transportit, leje transporti, licence transporti të leshuara nga autoritetet perkatëse. Në rastin e mjeteve të tjera, duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Ose

- b) **Kontratën e marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) si dhe certifikaten e transportit nga autoritetet perkatëse për vetë dhe të tjerë (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse të qerasë / furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve**

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjetit/pajisjeve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjetit dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6,

germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Makinerite jane vendosur duke u bazuar ne zerat e punimeve te preventivit.

Kamioni do te sherbeje per transportin e materialeve dhe hedhjen e mbeturinave ne vendin e depozitimit.

Betonieria do te sherbeje per prodhimin e llaçit dhe te betonit.

Depozita e ujit eshte e domosdoshme per te mbajtur rezerva uji per pergatitjen e llaçit, te betonit apo edhe punimeve te tjera te cilat e kane te nevojshme perdorimin e ujit.

Matrapik do te sherbeje per prishjet qe jane parashikuar te behen gjate punimeve.

1.3.4 Afati i kryerjes së punimeve:

Afati i kryerjes se punimeve eshte 6 (gjashte) jave .

Operatori Ekonomik duhet te paraqese grafikun e punimeve ne perputhje me afatin kohor qe eshte lene ne dispozicion per realizimin e kontrates.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat

“a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.